

Projekte të financuara nga BE për mbështetje të Kulturës

Konservim dhe rivitalizim i lokalitetit kulturor - turistik Shën Gjorgji në Nagoriçan të Vjetër



Në nëntor të vitit 2013, filloi projekti i financuar nga BE për konservim dhe rivitalizim të vendit kulturor-turistik Shën Gjorgji në Nagoriçanë të Vjetër, i financuar me **1.42 milion EURO** në kuadër të Instrumentin e Bashkimit Evropian për Asistencë Para-Aderimi. Konservimi dhe rivitalizimi i kësaj trashëgimie të jashtëzakonshme kulturore, Kisha origjinale që është ndërtuar nga

Perandori Bizantin Romak IV Diogjeni në vitin 1071, është element i rëndësishëm i promovimit të turizmit dhe rigjenerimit ekonomik të rajonit.

Aktivitetet e projektit janë ndarë në dy komponentë: 1) vendim për dhënie të grantit për Qendrën Nacionale për Konservim, për konservimin e kishës Shën Gjorgji dhe 2) punime për intervenime në rrethinën e drejtpërdrejtë të monumentit: kulla e kambanës, muret rrethuese të kishës, varret në oborrin e kishës, vendi oshënarit i Shën Prokorit nga Pçinja, shkolla e vjetër që do të shndërrohet në etno-muze, sheshi i fshatit dhe shatërvani.

Përkrahja për lokalitetin kulturor-turistik Nagoriçan i Vjetër është duke u zgjeruar në kuadër të Procesit të Lubjanës që është iniciativë rajonale për trashëgiminë kulturore me fokus në Evropën Juglindore e nën menaxhim të përbashkët të Këshillit të Evropës dhe Komisionit Evropian.

Për fat të keq, konservimi i kishës "Shën Gjorgji" nuk është kompletuar gjatë kohëzgjatjes së projektit.



Ndërtesa e Shoqërisë Civile dhe Programi i Medieve 2014

Pjesëmarrje qytetare për Demokraci Lokale – Projekti ka mundësuar që shoqëria qytetare të merr pjesë në nismë për inkurajim të mëtutjeshëm të demokracisë pjesëmarrëse në nivel lokal. Projekti ka krijuar mjedis në të cilin OShC-të do të bëhen aktorë aktiv në proceset e vendimmarrjes dhe në krijimin e politikave lokale dhe mendimit publik në sferën e kulturës, duke e stimuluar në këtë mënyrë mësimin dhe pjesëmarrjen qytetare. [Buxheti total: 286,950 EURO/ Kontribut i BE-së: 257,000 EURO]

Projekte të financuara nga BE-ja në kulturë dhe trashëgiminë kulturore nëpërmjet Instrumentit për Ndihmë Para-Aderuese (IPA), Bashkëpunimi Ndër-kufitar (BNK) Shqipëri – ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, 2007-2013

Kufij pa vija kufitare – Qëllimi i projektit është të vendosen relacione të qëndrueshme ndër-kufitare mes Manastirit dhe Korçës përmes hapjes së kanaleve të komunikimit dhe krijimit të veglave, për të zhvilluar partneritet afatgjatë dhe resurse për rrjetëzim të të dhënave në mënyrë që këto relacione të mirëmbahen gjatë viteve në vijim. [Buxheti total: 83,550 EURO/ Kontribut i BE-së: 48,099 EURO]

Trashëgimia e Botës në Duart Tuaja – Duke mbrojtur bashkërisht Kulturën dhe Natyrën tonë – Qëllimi i përgjithshëm i projektit ishte të aftësohen nxënësit e shqiptarë dhe maqedonas të shkollave të mesme të mësohet të çmojë diversitetin dhe të mbrojë trashëgiminë kulturore dhe natyrore botërore dhe të tyre. [Buxheti total: 65,214 EURO/ Kontribut i BE-së: 54,845 EURO]

Gra-Rojtare dhe qendra për krijimi të teatrove – Qëllimi i përgjithshëm i Aksionit është të stimulohet punësimi i femrave në fushën artistike dhe të këmbehen përvoja dhe praktika në punën ndërkulturore. [Buxheti total: 80,000 EURO/ Kontribut i BE-së: 66,400]

Fuqizimi i grave në fushat turistike nëpërmjet produkteve artizanale – Ky projekt ka kontribuar në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe atraktivitetin e Rajonit të Korçës në Shqipëri dhe Rajonit të Strugës në *Maqedoni*. I njëjti ka përforcuar kapacitetet dhe bashkëpunimin ndërkufitar mes palëve lokale dhe institucioneve në menaxhimin dhe programimin e zhvillimit të turizmit rajonal kulturor, e ka rritur rolin e trashëgimisë kulturore në zhvillimin social dhe ekonomik, e ka ngritur vetëdijen për pasuritë kulturore të rajoneve nëpërmjet përhapjes së strukturuar dhe profesionale të informatave dhe aktiviteteve socio-kulturore duke synuar audiencat nga vendi dhe nga jashtë, tregje dhe klientë, ka fuqizuar kapacitetet e artizanëve lokalë për të arritur në tregjet ndërkombëtare dhe turistike nëpërmjet krijimit të tre inkubatorëve të biznesit artizanalë dhe një sërë trajnimesh që janë realizuar me përfshirje të posaçme të femrave të rajonit ndër-kufitar. [Kontribut i BE-së: 83,470 EURO]

Aplikim i artit atje ku është e vështirë të flitet – këmbime mes artistëve të cilët punojnë në sferën sociale – Qëllimi i përgjithshëm ishte të krijohet rrjet i organizatave të Shoqërive Civile kulturore, institucioneve lokale, grupeve të themeluara nga komunitetet dhe artistët të cilët punojnë me grupe të lëndueshme duke përdorur aktivitete artistike në të dy anët e kufirit mes Shqipërisë dhe ish Republikës jugosllave të Maqedonisë. [Buxheti total: 58,360 EURO]

Ditët e kulturës së Romëve – Qëllimi i përgjithshëm ishte qasje socio-kulturore për kohezion social dhe prezantimin e Romëve në shoqëri, duke mësuar për vlerat kulturore dhe tradicionale, shembujt pozitiv të arsimit, këmbim të informatave dhe përvojave mes romëve dhe të tjerëve. [Buxheti total: 47,684 EURO]

Ruajtja e trashëgimisë unike dhe këmbim kulturor mes Bilishtës dhe Bërvenicës – Synimi është identifikimi, dokumentimi dhe promovimi i objekteve, praktikave dhe tipareve të dalluara të trashëgimisë kulturore dhe të vendosen kushte për zhvillim të qëndrueshëm të diversitetit kulturor, të promovohet kultura e grupeve të ndryshme etnike, të institucionalizohet bashkëpunimi në fushën e promovimit të diversitetit kulturor përmes qasjes sistematike dhe strukturale dhe të inkurajohen përfaqësuesit e grupeve etnike në rajonin ndër-kufitar. [Buxheti total: 49,918 EURO]

Projekte të financuara nga BE-ja në kulturën dhe trashëgiminë kulturore nëpërmjet Instrumentit për Ndihmë Para-Aderuese (IPA), Bashkëpunim Ndër-Kufitar (BNK) Bullgari – ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, 2007-2013



Qendra për Trashëgimi Kulturor dhe Historike (QTKH) në Kriva Pallankë, Projekt i financuar nga BE-ja: Trashëgimia Kulturore – Urë për Ardhmëri të Përbashkët nën IPA – Programi për BNK Bullgari – ish Republika jugosllave e Maqedonisë 2007-2013

Kultura – urë e kohezionit – Qëllimi i projektit ishte të arrihet zhvillim i qëndrueshëm i rajonit kufitar duke shfrytëzuar trashëgiminë e begatshme kulturore dhe krijimin e aktiviteteve të përbashkëta novative kulturore dhe shërbime për inkurajimin e bashkëpunimit ndër-kufitar mes institucioneve kulturore të Komunës së Sandanskrit dhe Komunës së Novo Sellos. [Buxheti total: 276,923 EURO/ Kontribut i BE-së: 235,384 EURO]

Përmirësim i cilësisë së jetës nëpërmjet promovimit dhe zhvillimit të resurseve kulturore në rajonin Goce Dellçev dhe Kratovë dhe shndërrim në Qendër atraktive Arti – Qëllimi i projektit ishte të zhvillohen resurset kulturore të rajonit Goce Dellçev dhe Kratovës nëpërmjet krijimit dhe promovimit të pikturave, ksilografisë, fotografive të cilësisë së lartë dhe suvenireve të përgatitura prej materialeve natyrale [Buxheti total: 276,923 EURO/ Kontribut i BE-së: 235,384 EURO]

Turizmi – ardhmëria jonë e përbashkët prej në Strumë deri në Bregallnicë – Projekti ka synuar të tejkalohen barrierat dhe të mbështetet vetëdija dhe zhvillimi i resurseve natyrale dhe trashëgimisë kulturore-historike në burim relevant për intensifikimin dhe diversifikimin e ekonomisë rajonale. [Buxheti total: 285,527 EURO/ Kontribut i BE-së: 242,698 EURO]

Punëtori Ballkanike për Teatrin - Qëllimi i projektit ishte të promovohet bashkëpunimi ndër-kufitar mes artistëve të ri nga të dy anët e kufirit, në rajonet e Shtipit dhe Qustendillit, nëpërmjet punëtorive për teatro, fundjavave për këmbime kulturore, ekspozita të pikturave, performanca teatrale me kukulla etj. [Buxheti total: 69,380 EURO/ Kontribut i BE-së: 58,973 EURO]

Këmbimi kulturor – Përdorim i Përbashkët i Dallimeve Drejt Zhvillimit të Bashkuar Kulturor – Qëllimi i këtij projekti ishte të identifikohet, regjistrohet dhe të prezantohet trashëgimia kulturore folklorike e rajoneve të Dojranit dhe Nevestinos nëpërmjet informatave dhe aktiviteteve për vizibilitet në lidhje me trashëgiminë kulturore folklorike në të dy anët e kufirit dhe të mundësohet që qendra e sapo themeluar Kulturore-Informative në Nevestino dhe skena e re e ndërtuar e Vogël Verore në Dojran të përdoret për organizimin e shfaqjeve të ndryshme kulturore. [Buxheti total: 299,920 EURO/ Kontribut i BE-së: 254,932 EURO]

Ura Kulturore për Zhvillim të Qëndrueshëm Rajonal – Synimi i projektit ishte të rritet atraktiviteti i rajonit në bazë të ruajtjes së resurseve natyrale dhe trashëgimisë kulturore. [Buxheti total: 94,857 EURO/ Kontribut i BE-së: 80,628 EURO]

Transformim të vijave ndarëse në pikë kohezioni – Fokusi i projektit ishte të mbrohet dhe të shtohet motivimi për zhvillimin kulturor dhe turistik brenda rajonit ndër-kufitar të Dojranit dhe Qustendillit, duke i aftësuar në këtë mënyrë njerëzit nga të dy rajonet të vendosin dhe të mirëmbajnë bashkëpunim të qëndrueshëm dhe miqësi afatgjatë. [Buxheti total: 294,576 EURO/ Kontribut i BE-së: 250,389 EURO]

Trashëgimia Kulturore – Urë drejt Ardhmërisë së Përbashkët –

Qëllimi i projektit ishte të themelohet Qendër për Trashëgimi Kulturore dhe Historike (QTKH) në Kriva Pallankë në lokalet e rinovuara dhe të pajisura të Shtëpisë së Vjetër të Armatës dhe të përmirësohet infrastruktura e jashtme dhe e brendshme dhe të sigurohet pajisje për Qendrat Kulturore Kashta e Rrethit dhe Xhamia në Dupnicë, si dhe të organizohet ekspozitë e përbashkët e suvenireve artizanale të prodhuara nga studentët e Dupnicës dhe Kriva Pallankës. [Buxheti total: 286,776 EURO/ Kontribut i BE-së: 243,760 EURO]



Zhvillimi i bashkëpunimit kulturor ndër-kufitar – Qëllimi i projektit ishte të përmirësohet qasja dhe atraktiviteti i 2 lokaliteteve kulturore dhe plan i përbashkët për menaxhimin e lokacioneve kulturore në rajonin ndër-kufitar të Vinicës dhe Banjskos. [Buxheti total: 294,176 EURO/ Kontribut i BE-së: 250,050 EURO]

Nën qiellin e njëjtë – Qëllimi i këtij projekti ishte të zhvillohet dhe aktualizohet turizmi kulturor në rajonin Kriva Pallankë-Dupnicë nëpërmjet 1 km rrugë lokale deri në shenjtëroren e Shën Joakim Osogovski në fshatin Gradec, bazë të të dhënave të trashëgimisë sakrale në rajonin ndër-kufitar Kriva Pallankë-Dupnicë, ngjarjet vjetore si atraktivitet turistik dhe libër informatash për trashëgiminë sakrale të rajonit. [Buxheti total: 296,594 EURO/ Kontribut i BE-së: 252,105 EURO]



Identik në Dallimet Kulturore – Qëllimi i këtij projekti ishte të mbahet dhe të prezantohet kultura e rajonit nëpërmjet **krijimit dhe promovimit të** Shtëpisë së trashëgimisë kulturore dhe historike të Rillës dhe Etno Shtëpisë në Koçani si vend për paraqitjen e punimeve autentike dhe historisë së përbashkët të rajonit si dhe vendeve në të cilat zhvillohen aktivitete të ndryshme. [Buxheti total: 227,525 EURO/ Kontribut i BE-së: 193,396 EURO]

Kultura hap dyer për të mundësuar zhvillim – Qëllimi i projektit ishte të avancohet qasje publike në kulturën e rajonit dhe territoreve të Komunave të Konçes dhe Jakoruda, për të zhvilluar vetëdijesim kulturor në mesin e banorëve të rajonit ndër-kufitar dhe

për rinovimin dhe modernizimin e Qendrës Lokale në Jakorudë dhe Qendrës Multi-funksionale Kulturore në Konçe. [Buxheti total: 280,533 EURO/ Kontribut i BE-së: 238,453 EURO]

Kulturë Digjitale për Kohezion Rajonal: Bazë novative e të Dhënave për ngritjen e vetëdijes në zonën ndër-kufitare të dimensionit rajonal dhe Evropian të kulturës dhe përdorimin më të mirë të përbashkët të saj – Kulturë Digjitale për Kohezion Rajonal – Qëllimi i projektit ishte të krijohet model për digjitalizimin e kategorive të ndryshme të resurseve kulturore të cilat do të ishin shfrytëzuar në tërë rajonin ndër-kufitar. [Buxheti total: 99,533 EURO/ Kontribut i BE-së: 84,603 EURO]



Së bashku në traditat dhe në ardhmëri – SË BASHKU

– Projekti synon krijimin e kushteve më të mira për inkuadrim kreativ të të rinjve në aktivitete që kanë të bëjnë me traditën e përbashkët kulturore dhe bashkëpunimin mes nxënësve nga Shkolla e Mesme “Shën Cirili dhe Metodij”, Qustendill, Bullgari dhe Shkollës Fillore Komunale “Nikolla Karev”, Probishtip, MK. [Buxheti total: 97,869 EURO/ Kontribut i BE-së: 83,188]

Trashëgimia Kulturore e Paraardhësve tanë – Shtylla Shpirtërore e Ardhmërisë sonë të përbashkët Evropiane – Objektivi kryesor i projektit është të ofrohet

mundësia për pjesëmarrësit në ngjarjet kulturore të projektit (grupe kulturore dhe folklorike, performues individual, artistë, artizanalë për të paraqitur dhuratat e tyre) për vendosjen e kontakteve të reja ndër-kufitare, partneriteteve, iniciativave dhe këmbimeve për know-how në rajonin e Kriva Pallankës dhe Qustendillit. [Buxheti total: 97,156 EURO/ Kontribut i BE-së: 82,582 EURO]



Përvijim i trashëgimisë kulturore në komunat e Strumjanit dhe Karbincit dhe simulime të zhvillimit të turizmit kulturore nëpërmjet produkteve të integruara turistike – C.U.L.T. – Qëllimi i projektit është të themelohet bazë e të dhënave për lokacionet kulturore me turistë në komunat Strumjani dhe Karbinci. [Buxheti total: 99,995 EURO/ Kontribut i BE-së: 84,996 EURO]

Turizëm kulturor- urë lidhëse mes popullatave në rajonin ndër-kufitar të Garmenit dhe Bosilovës – Qëllimi kryesor i këtij projekti është të mbrohet trashëgimia kulturore dhe të kontribuohet në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit kulturor në fshatrat e

Bosilevës dhe Garmentit nëpërmjet rinovimit të qendrave kulturore në të dy fshatrat. [Buxheti total: 196,194 EURO/ Kontribut i BE-së: 166,765 EURO]

Rock dhe Pop të Kufijve – Qëllimi i projektit ka qenë të themelohet dhe promovohet web platformë e përbashkët për rok dhe pop muzikë të re nga të gjitha rajonet ndër-kufitare me çka do të promovohet muzika e tyre në mesin e audiencave ndër-kufitare. [Buxheti total: 82,119 EURO/ Kontribut i BE-së: 69,801 EURO]

Aktivizim të Trashëgimisë në RNK BG-MK – Qëllimi i këtij projekti është të inspirohen dhe të inkurajohen personat e rinj në Komunën Shtip dhe Rajonin e Bllagoevgradit të ndërmarrin aktivitete sipërmarrëse dhe të zgjerojnë perspektivën e tyre nëpërmjet demonstrimit të formave të reja të udhëheqjes së biznesit. [Buxheti total: 82,119 EURO/ Kontribut i BE-së: 69,801 EURO]

Kulturë, Tradita dhe Histori të Përbashkëta – Lidhje për Ardhmërinë tonë Evropiane – Qëllimi i këtij projekti është të përmirësohet cilësia e jetës së rajoneve nëpërmjet detektimit të sferave të reja të intervenimit në bashkëpunimin ndër-kufitar mes zonave të Komunës Banjsko dhe Gjevgjeli, nëpërmjet punës në fushat e zhvillimit kulturor, rivitalizimit të infrastrukturave specifike kulturore, zhvillimit të perspektivave të turizmit kulturor dhe tjera. [Buxheti total: 298,963 EURO/ Kontribut i BE-së: 254,119 EURO]

Portë e hapur për Këmbim Kulturor – Ndërtim të Ardhmërisë së Përbashkët Evropiane – Qëllimi i këtij projekti është të hapen mundësitë për bashkëpunim kulturor të qëndrueshëm ndër-kufitar mes komunave Bogdanci dhe Qustendill. [Buxheti total: 295,597 EURO/ Kontribut i BE-së: 251,258 EURO]

Përmirësim i Cilësisë së Jetës në Rajonin Ndër-Kufitar nëpërmjet Promovimit dhe Rivitalizimit të Trashëgimisë së Përbashkët Kulturore – Qëllimi i projektit është të fuqizohet bashkëpunimi ndërmjet SHKA “Goce Dellçev” – Dellçevë dhe Asociacionit “Njerëz dhe tradita” nga Brezhani, si dhe ndërmjet artistëve, performuesve, valltarëve, këngëtarëve, piktorëve të vendit. [Buxheti total: 90,250 EURO/ Kontribut i BE-së: 76,712 EURO]

Projekte të financuara nga BE-ja në kulturën dhe trashëgiminë kulturore nëpërmjet Instrumentit për Ndihmë Para-Aderuese (IPA), Bashkëpunimi Ndër-Kufitar (BNK) Greqi – ish Republika jugosllave e Maqedonisë, 2007-2013

Lhi-Lna 2 - Qëllimi i projektit është të mbrohen resurset historike dhe natyrore të zonës ndër-kufitare në Novaci, Mariovë dhe Almopia, duke përfshirë edhe brendinë e kishës Shën Dimitriu në Gradesnicë dhe monumentet bizantine të Almopisë dhe ngritja e vetëdijes së zonave të përfshira si destinacione atraktive të turizmit alternativ. [Buxheti total: 319,954 EURO/ Kontribut i BE-së: 271,960 EURO]

Prespa – Qëllimi kryesor i projektit është të nxirret në pah trashëgimia dhe resurset e pasura kulturore të rajonit, si dhe konsiderueshëm të fuqizohet dinamika e saj artistike nëpërmjet themelimit të institucionit të ri si pikë referuese, “Festivali Ndërkombëtar i Prespës” [Buxheti total: 154,100 EURO/ Kontribut i BE-së: 130,985 EURO]

Promo.Cross – Qëllimi i projektit është të promovohen monumente religjioze dhe arkitektura tradicionale në zonat e Kilkisit dhe Krushevës nëpërmjet digjitalizimit, 3D modelimit, GIS aplikacion që mund të gjendet në ueb portal, DVD dhe publikime. [Buxheti total: 111,564 EURO/ Kontribut i BE-së: 94,829 EURO]

KONCERT - Qëllimi i projektit është të mbështetet muzika korale në rajonin e Manastirit dhe Selanikut dhe të stimulohen aktivitete të përbashkëta të qëndrueshme muzikore nëpërmjet kampeve të përbashkëta verore dhe interpretime të përbashkëta të koreve nga të dy vendet në të dy anët e kufirit. [Buxheti total: 44,842 EURO/ Kontribut i BE-së: 38,115 EURO]

Ndërvepro – Qëllimi i këtij projekti është të stimulohet dialogu ndërkulturor, bashkëpunimi ndërkombëtar kulturor, shprehja artistike dhe qarkullimi i produkteve artistike në rajonin e Manastirit dhe Selanikut, nëpërmjet seminareve, ekspozitave, zbatimit të kurseve artistike për trajnim etj. [Buxheti total: 127,499 EURO/ Kontribut i BE-së: 108,374 EURO]

Kajmak – Qëllimi i projektit është të mbështeten forma alternative të turizmit dhe të promovohet gastronomia ndër-kufitare nëpërmjet eksploatimit të trashëgimisë ekzistuese natyrore dhe kulturore të rajonit ndër-kufitar të Kavadarit dhe Edesës. [Buxheti total: 68,928 EURO/ Kontribut i BE-së: 58,588 EURO]

Mbrojtje e trashëgimisë (faza 1) – Qëllimi i projektit është të kontribuohet në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të rajonit NK nëpërmjet konservimit, restaurimit dhe rikonstruktimit të Fortifikatës së Perandorit në Strumicë, përfundim të kishës së Shën Gjorgjit në Kilkis dhe ndërtim të rrugës Natyrore-historike-kulturore në kodrën e Shën Gjorgjit. [Buxheti total: 324,659 EURO/ Kontribut i BE-së: 275,960 EURO]

Mbrojtje e trashëgimisë (faza 2) – Konservimi, restaurimi dhe rikonstruktimi i Fortifikatës së Perandorit (faza e 2-të); kishës së Shën Gjorgjit në Kilkis; ndërtim të rrugës Natyrore-historike-kulturore në Kodrën Shën Gjorgji në Kilkis dhe përgatitje të studimit për adaptimin dhe ripërdorimin e ndërtesave të numëruara të Prefekturës së Vjetër të Kilkisit. Dukshmëria e përmirësuar dhe interpretimi dhe promovimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore do të zmadhojë ardhjen e turistëve dhe në këtë mënyrë do të krijohen vende të reja pune që si rrjedhojë i zmadhon të hyrat e popullatës. [Buxheti total: 324,659 EURO/ Kontribut i BE-së: 275,960 EURO]

Prom-Cult – Qëllimi i projektit është të përforcohet turizëm i qëndrueshëm lokal nëpërmjet promovimit të trashëgimisë kulturore vllahe të rajonit Kionkori dhe Komunës së Konçes. [Buxheti total: 170,938 EURO/ Kontribut i BE-së: 145,297 EURO]

Lhi-Lna – Qëllimi i projektit është të promovim i përbashkët i resurseve historike dhe natyrore të zonës ndër-kufitare në Novaci, Mariovë dhe Almopi nëpërmjet dokumentimit dhe eksplorimit të lidhjeve mes monumenteve historike dhe lokaliteteve natyrore të secilës zonë dhe promovimin e tyre si lokacione të vlefshme turistike. [Buxheti total: 267,214 EURO/ Kontribut i BE-së: 227,132 EURO]

Projekte të financuara nga BE-ja në kulturën dhe trashëgiminë kulturore nëpërmjet Instrumentit për Ndihmë Para-Aderuese (IPA), Bashkëpunimi Ndër-Kufitar (BNK) Kosovë – ish Republika jugosllave e Maqedonisë, 2007-2013

Kultura në Aksion – Qëllimi i këtij projekti është të përmirësohet cilësia e jetës në rajonin rural ndër-kufitar të Likovës dhe Vitisë nëpërmjet sigurimit të qasjes në rrjetet kulturore dhe të krijimit për zhvillim të qëndrueshëm kulturor dhe promovimin e trashëgimisë kulturore. [Buxheti total: 250,000 EURO/ Kontribut i BE-së: 212,500 EURO]

Pjesëmarrje e ish Republikës jugosllave të Maqedonisë në ERDF Programin Ndërkombëtar për Bashkëpunim Territorial ‘Evropa Jug-Lindore’

Arritje të QËNdrueshmërisë nëpërmjet qasjes së integruar të menaxhimit të Trashëgimisë KULTurore (QËNDKULT) – QËNDKULT kishte për qëllim të vendosen rrjete lokale nëpërmjet inkuadrimin aktiv të një spektri të gjerë të palëve të interesuara nga lokacionet e synuara kulturore: ekspertë profesional, shërbëtor civil, organizata joprofitabile, operatorë turistik, aktorë financiar, etj. Shfrytëzuesit kanë kaluar trajnime intensive për konservimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të trashëgimisë kulturore të organizuara nga qendra të larta arsimore. [Buxheti total: 78,080 EURO/ Kontribut i BE-së: 65,376 EURO]

Vlera Kulturore për Menaxhim të Qëndrueshëm Territorial dhe Marketing (KULTEMA) – Projekti KULTEMA synon zhvillimin e strategjisë së përbashkët të marketingut për rritjen e investimeve në trashëgiminë kulturore, duke themeluar kapacitete të reja dhe duke aplikuar modele novative të menaxhimit, të afta për të minimizuar barrierat administrative, sociale dhe ekonomike ndërmjet trashëgimisë kulturore dhe investitorëve potencial. [Buxheti total: 73,101 EURO/ Kontribut i BE-së: 59,895 EURO]

Përforcim të Trashëgimisë Kulturore nëpërmjet Planifikimit dhe Menaxhimit Mjedisor (CHERPLAN) – Qëllimi i projektit ka qenë të sigurohet bazë e fortë për të ofruar kompatibilitet dhe sinergji ndërmjet konservimit të trashëgimisë kulturore dhe zhvillimit

socio-ekonomik nëpërmjet inkurajimit të përvetësimit të qasjes moderne të Planifikimit Mjedisor nëpërmjet EJL. [Buxheti total: 86,679 EURO/ Kontribut i BE-së: 68,409 EURO]